



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:006694  
Datë: 15.02.2021  
Numri i dokumentit: 01508854

**C.nr.74/2021**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil**, Gjyqtari Ahmet Idrizaj, me zyrtaren ligjore Albana Curri, në çështjen kontestuese të paditësit M. B nga Gjakova, të cilin e përfaqëson i autorizuari Arben Biblekaj, avokat në Prishtinë, adresa Rr. “Fehmi Agani” Hy 25/4, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në Prishtinë, për kompensim dëmi, vlera e kontestit 450,00€, jashtë shqyrtimit, me datë **15.02.2021**, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**PËR SHKAK TË HEQJES DORË NGA KËRKESËPADIA**

**REFUZOHET** si e pathemeltë kërkesë padia e paditësit M. B nga Gjakova, me të cilën ka kërkuar që të **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në Prishtinë, që në emër të dëmit material dhe jo material, të ia kompensojë shumën prej 450,00€, si dhe shpenzimet e shkaktuara procedurale në lartësi prej 259,00€, në afatin prej 7 ditëve, **REFUZOHET** në tërësi si e pathemeltë.

**A r s y e t i m**

Paditësi me padinë e tij të parashtruar në këtë gjykatë, me datë 13.01.2021, nëpërmes të autorizuarit të lartpërmendur të tij ka kërkuar që gjykata të e detyrojë palën e paditur - Kompaninë e Sigurimeve “S.” me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material, të ia kompensojë shumën prej 450,00€, si dhe shpenzimet e shkaktuara procedurale në lartësi prej 259,00€.

I autorizuari i paditësit me parashtrësën e datës 11.02.2021, ka theksuar se paditësi me të paditurën e lartpërmendur, me datë 27.01.2021, kanë lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore, për shumën e lartcituar të cilën e paditura e ka përmbushur në tërësi, ashtu që për këtë arsye ka hequr dorë nga kërkesëpadia.

Meqë gjykata pas heqjes dorë nga kërkesëpadia nga ana e të autorizuarit të paditësit në raport me kompensimin e dëmit – material dhe jo material, në kuptim të nenit 149 par. 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet : *“Në qoftë se paditësi, deri në përfundimin e seancës së shqyrtimit kryesor të çështjes, heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadisë, apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm, e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë, apo në tërësi”* - (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë), pa shqyrtim të mëtejshëm, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**

**C.nr.74/2021, datë 15.02.2021**

**GJYQTARI,  
Ahmet Idrizaj**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankesë në afatin prej 15 ditëve, nga dita e pranimi, Gjykatës së Apelit të Kosovës, e nëpërmes të kësaj gjykate.

Në kuptim të nenit 182 par. 2 të LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, apo nga shkak se: heqja dorë nga kërkesëpadia, është dhënë në lajthitje, apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.